



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
KOMISIONI INSTITUCIONAL I ZGJEDHJEVE

Nr 311 / Prot
3

Tiranë, më 30/06/2021

NJOFTIM

“Për kriteret dhe dokumentacionin që duhet të plotësojnë kandidatët që aplikojnë për anëtar të Senatit Akademik, përfaqësues i studentëve”

Kandidati për anëtar në Senatin Akademik, përfaqësues i studentëve duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Nenin 18, pika 3 dhe Nenin 22, pika 2 të rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet drejtuese dhe Senatin Akademik në Akademinë e Studimeve Albanologjike”, si dhe duhet të dorëzojë pranë sekretares së KIZ dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) kërkesën për kandidim, e cila përfshin, emrin, atësinë, mbiemrin, datëlindjen, gjininë dhe shprehjen e vullnetit për kandidim;
- b) kopje të dokumentit të identifikimit;
- c) Vërtetimin që provon se është student me kohë të plotë në një nga njësitë kryesore të ASA -së;
- d) propozimin nga jo më pak se 5 studentë pjesë e trupës zgjedhore, sipas standardeve të parashikuara në këtë rregullore, të cilët krahas emrit, mbiemrit dhe nënshkrimit vendosin në shkresën e propozimit edhe numrin personal të kartës së identitetit;

KRYETAR

Hasan Bello

